



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 nëntor 2014
Nr. ref.:RK721/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI107/14

Parashtrues

Xufe Rracaj

**Njoftim i Prokurorit të Shtetit, KMLC Nr. 01/2011,
i 13 dhjetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Xufe Rracaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLC Nr. 01/2011 të 13 dhjetorit 2013.
3. Parashtruesja e kërkesës deklaroi se njoftimi i kontestuar i ishte dorëzuar asaj më 23 maj 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkëlur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me *“nenin 6 (...) dhe nenin 5 të Kushtetutës”*, si dhe *“të drejtën për kompensimin e të ardhurave personale”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 1 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Prokurorit të Shtetit.
9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan, si gjyqtar kryesues të Kolegjit shqyrtues me gjyqtaren Snezhana Botusharova.
10. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 30 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, në procedurën përmbartimore, të iniciuar nga parashtruesja e kërkesës, detyroi (E. nr. 322/2003) OP “Kosovodrvo-Commerce” t’i paguajë parashtrueses së kërkesës një shumë të caktuar të hollave.
12. Në një datë të pacaktuar, OP “Kosovodrvo-Commerce” ushtroi ankesë kundër aktvendimit të lartcekur.

13. Më 30 gusht 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 563/2009) e aprovoi ankesën e debitorit. Në këtë mënyrë, ishte refuzuar përmbarimi i Aktvendimit të Gjykatës Komunale.
14. Gjykata e Qarkut arsyetoi se Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion material për të trajtuar propozimin e parashtrueses së kërkesës. Sipas Gjykatës së Qarkut *“Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës është kompetente për të vendos lidhur me këtë çështje, duke u bazuar në nenin 29 të Rregullores së UNMIK-ut.... fakti se ndërmarrja e paditur - debitori ka qenë nën autoritetin administrativ të AKM-së vërtetohet në bazë të shkresës së AKM-së numër DN- CS606 të datës 27.06.2006 drejtuar të gjitha gjykatave...”*.
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Prokurori i Shtetit mbrojtjen e ligjshmërisë, duke pretenduar se Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi që, sipas parashtrueses së kërkesës, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte juridiksion material për përmbarimin e çështjes në fjalë.
16. Më 18 janar 2011, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC Nr. 01/2011) bëri përpjekje që ta informojë parashtruesen e kërkesës në adresën postare Rr. Rijeka nr. 46/A se *“nuk kam gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë”*.
17. Më 11 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës kërkoi informata lidhur me statusin e kërkesës së saj për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar se *“ka mbi tri vite që s’më keni kthyer kurrë përgjegjëje se çka ka ndodhë me kërkesën time”*.
18. Më 13 dhjetor 2013, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KLC Nr. 01/2011) e informoi parashtruesen e kërkesës në adresën postare *“Lidhja e Lezhës”* nr. 70/3 se *“...siç shihet ju njoftimin [e 30 dhjetorit 2010] nuk e keni pranuar për arsye se adresa e juaj s’ka qenë e saktë. Po ju dërgojmë edhe një herë këtë njoftim në adresën e re dhe bashkangjitur gjeni edhe njoftimin e dërguar më parë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, *“të gjitha mjetet juridike janë ushtruar por ka qenë e kotë dhe paramendoni nga viti 2003 deri 2008, nuk është shqyrtu kërkesa-propozimi; pastaj Prokuroria nga viti 2010- deri 2014, dt 23.05.2014 nuk ka qenë në gjendje të njoftoj palën. Kemi menduar se së paku Prokurori do të ngritë Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse lejohet sipas LPP-së në fuqi [Ligji për Procedurën Përmbarimore]”*.
20. Prandaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata *“Të konstatohet shkelja nga Gjykata dhe Prokurori i Shtetit. Të më njihet e drejta në kompensim të pagave (e drejta e punës) e drejtë themelore. Të më bëhet pagesa (të urdhërohet AKP)”*.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
23. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) c) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: ... c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.
(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:... d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
24. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar kërkesën e saj, pretendon shkelje të neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me gjuhët dhe simbolet e Republikës së Kosovës dhe asgjë me faktet e kërkesës. Pra nuk është e qartë se cilat janë pretendimet e parashtrueses së kërkesës.
25. Siç shihet objekti i çështjes ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të drejtës në pronë.
26. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar dhe nuk ka treguar si dhe pse pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj qoftë për gjykim të drejtë apo e drejta pronësore.
27. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkritazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ], 1999-I; Shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08 të 7 shkurtit 2011).
28. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ, Vendim përkritazi me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

29. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani